

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI: PENAL



PUNIM DIPLOME

TEMA:

**METODAT BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE PËR REGJISTRIMIN
DHE IDENTIFIKIMIN E KRYESËVE TË VEPRAVE PENALE**

Mentori:

Prof. Dr. Haki Demolli

Kandidatja:

Zana Shala

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Kryerja e veprës penale në aspektin kriminalistik përcillet me një varg karakteristikash dhe rrethanash, të cilat dallojnë në masë të madhe nga veprimet dhe dukuritë tjera shoqërore. Për t'u kryer një vepër penale duhet ekzistuar personi i cili ka kryer veprimin apo mosveprimin me të cilin është shkaktuar pasoja, pastaj ekziston mjeti dhe mënyra e kryerjes si dhe sendet apo objektet të cilat janë atakuar, apo në të cilat kanë mbetur gjurmët e veprës penale.

Teknika regjistruese kriminalistike është degë e kriminalistikës që merret me kërkimin dhe përsosjen e metodave shkencore- teknike që do të përshtateshin për regjistrimin e personave, ngjarjeve dhe sendeve me qëllim që të bëhet identifikimi i tyre. Nocioni i teknikës regjistruese përfshinë dy pjesë: regjistrimin kriminalistik dhe identifikimin kriminalistik.

Regjistrimi kriminalistik paraqitet si mjet përmes së cilit arrihet identifikimi kriminalistik. Me regjistrimin kriminalistik kuptojmë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për personat që regjistrohen, por edhe për ngjarje dhe sende, me qëllim të shfrytëzimit operativ të tyre për të identifikuar persona, sende dhe për ndriçimin e veprave penale.

Regjistrimi dhe identifikimi i personave të cilët me veprimet e veta kanë shkaktuar pasoja të dëmshme shoqërore është i rëndësishëm së dyfishtë, përmes tij mund të gjendet, kapet dhe ndëshkohet kryesi i veprës penale e sidomos recidivisti dhe përmes regjistrimit kriminalistik iu bëhet me dije qytetarëve, organeve dhe institucioneve të ndryshme shtetërore se prej cilëve persona duhet pasur kujdes, nga kryerja eventuale e kriminalitetit.

Duke pasur parasysh punën dhe përvojat e organeve të policisë në shtete të ndryshme të botës, mund të thuhet se sot zbatohet një numër tejet i madh i metodave për regjistrimin dhe identifikimin e personave. Metoda të tilla janë: metoda e përshkrimit personal, metoda e fotografisë regjistruese- identifikuese (sinjalitike), metoda e daktiloskopisë, metoda e foto-robotit, metoda e identikitit, metoda foto-fit, metoda e fonoskopisë, metoda e ADN-së, metoda e palinologjisë mjekoligjore etj.

Duke njohur këto metoda më mirë, njëkohësisht do të arrihet të kuptohet se si bëhet regjistrimi dhe identifikimi i kryesëve të veprave penale, si ka arritur të parandalohet kriminaliteti përmes aplikimit të metodave të regjistrimit dhe identifikimit kriminalistik, si është bërë identifikimi i kriminelëve përmes këtyre metodave, si është arritur të provohet se një person ka qenë kryes i veprës penale dhe si bëhet regjistrimi i kryesëve të veprave penale nga organet e policisë.

Poashtu është e rëndësishme të njihen metodat e regjistrimit dhe identifikimit kriminalistik individualisht, duke analizuar dhe studiuar secilën metodë, sepse secila dallon nga tjetra për nga mënyra e aplikimit dhe ka rëndësinë dhe veçoritë e saj.

Fjalët kyçe: *Teknika regjistruese kriminalistike, regjistrimi kriminalistik, identifikimi kriminalistik, metodat kriminalistike.*